

VENDIM
Nr. 69, datë 8.10.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 8.10.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 2 (I) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Tomor Bylykbashi, përfaqësuar nga avokate Evis Miço, me prokurë.

Satliko Bylykbashi, përfaqësuar nga avokate Evis Miço, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Ministria e Financave, përfaqësuar në gjykim nga sekretarja e përgjithshme, Risena Xhaja.

Dega e Thesarit Korçë

Bashkia Korçë

Rajmonda Troja

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2661, datë 10.12.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-4181 (341), datë 19.10.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 41, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Financave, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjekteve të interesuara, Bashkisë Korçë, Degës së Thesarit Korçë dhe Rajmonda Troja, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasit Tomor Bylykbashi dhe Satliko Bylykbashi (*kërkuësit*) janë trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të trashëgimlënësit H.B., në bazë të vendimit nr. 2199 (41-2012-03791), datë 12.9.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore. Nga aktet rezulton se i ndjeri H.B., në datën 20.11.1958, kundrejt shumës 150.000 lekë, ka blerë nga shtetasi Sh.K. një shtëpi banimi, të ndodhur në Korçë, e cila aktualisht rezulton e regjistruar me numër pasurie 6/501, zona kadastrale nr. 8564, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë.

2. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Korçë, me vendimin nr. 604, datë 23.12.1994 (*vendimi nr. 604/1994*), ka vendosur të njohë shtetasin B.V. si ish-pronar të kësaj shtëpie, duke ia kthyer atë trashëgimtarëve të tij. Po sipas vendimit të KKKP-së, Korçë shteti i detyrohej

shtetasit H.B. pagesën e masës së shpërblimit, sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit të shtëpisë, të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, sipas kontratës së shitblerjes. Ky përcaktim bazohet në nenin 10, paragrafi i parë, të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (*ligji nr. 7698/1993*), i cili rregullonte çështjen e ndërtesave të ish-pronarëve që janë tjetërsuar në persona të tretë, duke parashikuar se ndërtesat do t’u kthehen ish-pronarëve, ndërsa personat e tretë do të marrin masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve.

3. Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), me vendimin nr. 12, datë 21.3.2000 (*vendimi nr. 12/2000*), ka shfuqizuar pjesërisht nenin 10, paragrafi i parë, të ligjit nr. 7698/1993, si të papajtueshëm me Kushtetutën, duke arsyetuar, ndër të tjera, se rregulli për masën e shpërblimit për ndërtesat ish-pronë private që janë tjetërsuar nga persona të tretë, duke mos marrë për bazë çmimin e tregut, pra vlerën reale që ka ndërtesa në momentin e dorëzimit tek ish-pronari, vjen në kundërshtim me parimin e barazisë përpara ligjit.

4. Në vitin 2013, duke qenë se shtëpia e banimit të lartpërmendur posedohej ende nga kërkuesit, shtetasi N.V., në cilësinë e trashëgimtarit të ish-pronarit B.V., i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e kërkuesve t’ia lirojnë dhe dorëzojnë atë (shtëpinë) atij dhe bashkëpronarëve të tjerë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 2338, datë 13.11.2013, ka vendosur pranimin e kërkesës. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 197, datë 9.6.2014 dhe, për rrjedhojë, në datën 26.8.2014, kërkuesit i kanë dorëzuar banesën trashëgimtarit të ish-pronarit B.V.

5. Pas dorëzimit të banesës, kërkuesit dhe shtetasja R.T. i janë drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e Ministrisë së Financave, Degës së Thesarit Korçë dhe Bashkisë Korçë për t’i paguar vlerën e plotë dhe reale të banesës në shumën 4.802.150 lekë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2014-3572 (1602), datë 29.10.2014, ka vendosur deklarin e moskompetencës lëndore të saj për gjykimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e saj në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 452, datë 22.9.2015, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e palës së paditur, Degës së Thesarit Korçë, që t’i paguajë secilit prej paditësve shumën prej 1.600.716,67 lekësh (1/3-ën pjesë secilit). Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka vendosur, gjithashtu, rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesve lidhur me palët e paditura, Ministrinë së Financave dhe Bashkisë Korçë, për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv në gjykim. Kundër këtij vendimi, Ministria e Financave, Dega e Thesarit Korçë dhe Avokatura e Shtetit kanë paraqitur ankim.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2661, datë 10.12.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesve, si të pambështetur në ligj, duke arsyetuar se kërkimi i tyre për të përfituar shpërblim të plotë dhe real për pasurinë-banesë që ata kanë pasur në posedim dhe që i është kthyer pronarit të ligjshëm, është i pabazuar në ligj e në prova, pasi nuk janë shpronësuar nga pala e paditur, por prona i është kthyer pronarit të saj. Sipas kësaj gjykate, në rastin konkret, gjen zbatim akti normativ nr. 3, datë 2012, “Për lirimin e banesave ish-pronarëve” (*akti normativ nr. 3/2012*) dhe ligji nr. 82/2012, datë 13.9.2012, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë të subjekteve të shpronësuar” (*ligji nr. 82/2012*). Këto akte parashikojnë se kategoria e personave që janë banorë në banesa, të cilat u janë kthyer ish-pronarëve, kanë të drejtën të aplikojnë dhe përfitojnë statusin e qytetarit të pastrehë, banues në banesat ish-pronë të subjekteve të shpronësuar dhe t’i drejtohen Entit Kombëtar të Banesave (*EKB*) për të përfituar kredi për banesë me kushte lehtësuese. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs kërkuesit.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4181(341), datë 19.10.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se rekursi i kërkuesve nuk ngrinte shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, që lidhen me zbatimin e keq të ligjit material dhe procedural dhe që e bënin të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit.

8. Në datën 19.2.2024 kërkesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit. Me vendimin e datës 19.4.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1.1. *Parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës private*, pasi përmes vendimmarrjeve të tyre, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë u kanë mohuar kërkesve të drejtën për shpërblim të drejtë, të përcaktuar me vendimin nr. 604/1994 të KKKP-së, Korçë, i cili përbën titull ekzekutiv. E drejta e pronës private për banesën është fituar përmes kontratës së shitblerjes. Edhe pse me vendimin nr. 12/2000 të Gjykatës është shfuqizuar pjesërisht neni 10 i ligjit nr. 7698/1993, lidhur me mënyrën e shpërblimit të personave të tretë, blerës të pronës në shtet, në thelb, nuk është mohuar e drejta e tyre për të përfitur një shpërblim të tillë.

9.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi arsyetimi i gjykatës së apelit se kërkesve nuk u është cenuar e drejta e pronësisë është i gabuar. Shtetasi H.B. ka qenë pronar i banesës objekt të vendimit të KKKP-së, Korçë, si dhe blerësi dhe pronari i fundit i kësaj shtëpie të konfiskuar e të shitur nga shteti personave të tretë. Kërkesit kanë pasur statusin e pronarit në bazë të kontratës së shitblerjes nga shitësi i mëparshëm, i cili sipas notës së transkriptimit të vitit 1958 është, gjithashtu, blerës i pronës nga shteti. Orientimi që gjykata e apelit i bën kësaj situatë juridike, në lidhje me statusin e të pastrehut, është tejet i gabuar, pasi kërkesit nuk kanë qenë qiramarrës në këtë pronë dhe as posedues të saj pa asnjë lloj tagri. Akti normativ nr. 3/2012 ka të bëjë me një tjetër situatë juridike që nuk përputhet me atë të kërkesve, të cilët nuk janë banorë të pastrehë në banesën e ish- pronarit. Edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pa arsyetuar asnjë nga shkaqet e ngritura në rekurs, ka dalë në përfundimin se vendimi i gjykatës së apelit duhej lënë në fuqi.

9.2. *E drejta për përfitimin e një shpërblimi të drejtë*, e garantuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës, si pasojë e zhveshjes nga e drejta e pronësisë të banesës së blerë prej shtetit (në cilësinë e blerësit të fundit). Trashëgimlënësi i kërkesve e ka fituar pronësinë për këtë banesë përmes kontratës së shitblerjes, sipas legjislacionit të kohës, dhe ka qenë pronar i saj që prej vitit 1958 deri në vitin 1994, kur kjo pronë i është kthyer ish-pronarit të saj në bazë të vendimit të KKKP-së, Korçë. Ky i fundit ishte i bazuar në nenin 10, paragrafi i parë, të ligjit nr. 7698/1993, sipas të cilit, personave të tretë shteti u kthente masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit, të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve. Nenit 10 i ligjit të mësipërm është shfuqizuar me vendimin nr. 12/2000 të Gjykatës dhe ligji nuk rezulton të jetë plotësuar më vonë me ndonjë dispozitë për të rregulluar këtë të drejtë. Gjykata ka shfuqizuar mënyrën e shpërblimit të personave të tretë, blerës të pronës në shtet, por nuk e ka shuar të drejtën e tyre për të përfitur një shpërblim të tillë, pasi ajo buron nga një vendim i KKKP-së, Korçë, i cili konsiderohet *quasi* gjyqësor, përbën titull ekzekutiv dhe është i detyrueshëm për t'u zbatuar. Kërkesit nuk kanë gëzuar statusin e të pastrehut, as të qiramarrësit në shtet dhe as qiramarrësit të ish-pronarit. Si të tillë, ata nuk janë subjekt i aktit normativ nr. 3/2012, të miratuar me ligjin nr. 82/2012. Në asnjë dispozitë të aktit normativ nuk ka parashikim për kategorinë e personave të tretë, të cilëve u është tjetërsuar prona, prandaj ky akt nuk mbush as vakumin ligjor të krijuar nga shfuqizimi i nenit 10 të ligjit nr. 7698/1993.

9.3. *Parimi i mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi vendimet e kundërshtuara i kanë vendosur kërkesit në pozita diskriminuese. Arsyetimi i gjykatës së apelit vjen në kundërshtim të hapur me provat e paraqitura, me ligjin, me vendimin nr. 12/2000 të Gjykatës, si dhe me praktika të ngjashme gjyqësore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Edhe në jurisprudencën kushtetuese është konsoliduar qëndrimi i Gjykatës në lidhje me pozitën e kësaj kategorie pronarësh, për sa i përket legjitimitetit të kërimit të tyre për përfitimin e dëmshpërblimit të drejtë nga shteti.

10. **Subjekti i interesuar, Ministria e Financave**, ka prapësuar si vijon:

10.1. *Për legjitimitetin e kërkesësve*

Në kuptim të nenit 112 të Kodit Civil (KC), kërkitimi i kërkesësve është i parashkruar, pasi nuk është ushtruar brenda afatit 10-vjeçar të përcaktuar në ligj. Atyre u ka lindur e drejta e ngritjes së padisë për kërkitimin e dëmshpërblimit nga vendimi nr. 604/1994 i KKKP-së, Korçë. Sipas nenit 117 të KC-së, afati i parashkrimit fillon nga data kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë. Kërkesit nuk kanë ndërmarrë asnjë hap prej vitit 1994 deri në vitin 2014, kur nga ish-pronari është vepruar ligjërisht për lirim të banesës së kthyer me vendimin e KKKP-së, Korçë. Në rastin konkret, nuk ekziston asnjë ngjarje që të ketë sjellë pezullimin ose ndërprerjen e parashkrimit.

10.2. *Për legjitimitetin aktiv të kërkesësve*

Kërkesit nuk janë subjekte të shpronësuar, në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (ligji nr. 9235/2004), ndaj nuk mund të legjitimohen në kërkitimin e tyre për dëmshpërblimin e një pasurie që nuk e kanë pasur në pronësi. Pasuria, për të cilën ata kërkojnë dëmshpërblim nga Ministria e Financave, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 7698/1993, u është kthyer ish-pronarëve me vendimin e KKKP-së, Korçë. Vetëm nota e transkriptimit nuk mund t’i legjitimojë paditësit për ngritjen e pretendimit në lidhje me dëmshpërblimin e një prone, të cilën ata nuk e kanë pasur të tyre. Kërkesit nuk mund të legjitimohen të vënë në lëvizje gjykatën, për sa kohë asnjë e drejtë e tyre nuk është cenuar nga veprimet e organeve të caktuara me ligj.

10.3. *Për legjitimitetin pasiv të subjekti të interesuar, Ministrisë së Financave*

Ministria e Financave nuk gëzon legjitimitet pasiv në cilësinë e të paditurës në gjykim, pasi nuk ka detyrim ligjor për shpërblimin e kërkesësve, për objektin e blerë nga shteti dhe të kthyer ish-pronarëve me vendimin e KKKP-së, Korçë, me vlerën e tregut, sepse asnjë akt nënligjor nuk e ngarkon këtë institucion shtetëror me këtë detyrim dhe as nuk i ka dhënë kompetencë për trajtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuar. Në bazë të vendimit nr. 355, datë 2.6.1998 të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit”, Ministria e Financave merr përsipër vetëm ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, sipas rasteve të përcaktuara taksativisht në këtë akt. Organi kompetent për shlyerjen e detyrimeve financiare që mund t’i lindin shtetit ndaj personave të tretë janë KKKP-të dhe seksionet e financës në bashki.

10.4. *Për themelin e kërkesës*

Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar. Me vendimin nr. 12/2000 të Gjykatës është vendosur shfuqizimi i pjesës së nenit 10 të ligjit nr. 7698/1993 që ka të bëjë me masën e shpërblimit për ndërtesat ish-pronë private, të tjetërsuara nga persona të tretë. Në kushtet e një vakumi ligjor për përcaktimin e masës së shpërblimit, në rastin konkret, referenca bëhet në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 9235/2004, sipas të cilit e drejta e shpërblimit në masën e çmimit të blerjes, konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, u njihet personave të tretë, vetëm në rastin kur mbi truall nuk ka ndërtesa të përhershme ose të ligjshme. Ligjvënësi ka nxjerrë aktin normativ nr. 3/2012, që ka plotësuar boshllëqet dhe paqartësitë që ekzistojnë në ligjet nr. 7698/1993 dhe nr. 9235/2004. Sipas këtij akti, EKB-ja i dërgon Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) listën e personave të shpronësuar, me qëllim që këta të fundit të përfitojnë kredinë me 0%, me afat 30 vjet. Pra, akti normativ ka përjashtuar çdo mundësi tjetër për personat e shpronësuar për të kërkuar shpërblim me rrugë gjyqësore. Fakti që kërkesit kanë neglizhuar për t’iu drejtuar EKB-së për të përfituar nga parashikimi i aktit normativ nr. 3/2012, nuk do të thotë se nga ana e gjykatave dhe institucioneve shtetërore është cenuar parimi i sigurisë juridike.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. *Për legjitimitetin e kërkesësve*

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të

garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Gjykata vlerëson se kërkuessit, si bartës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Në këtë drejtim, prapësimi i subjektit të interesuar, Ministrisë së Financave, se ata nuk legjitimohen në kuptim të nenit 112 të KC-së, pasi kërkimi i tyre është i parashkruar, duke mos u ushtruar brenda afatit 10-vjeçar të përcaktuar në ligj, nuk përbën argument kushtetues për legjitimimin *ratione personae* të kërkuessve.

13. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se palë e procesit gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuessit ka qenë edhe Ministria e Financave dhe në këtë cilësi është thirrur si subjekt i interesuar në këtë gjykim kushtetues. Prandaj, prapësimi i saj se nuk gëzon legjitimitet pasiv në gjykim, pasi nuk ka detyrim ligjor për shpërblimin e kërkuessve, duke qenë se asnjë dispozitë ligjore nuk e ngarkon me këtë detyrim, nuk është i bazuar.

14. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuessit kanë kundërshtuar vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të nisur prej tij. Pretendimet e tyre janë ngritur në thelb edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se ata nuk kanë më mjete të tjera ankimi ndaj vendimeve të kundërshtuara, për rrjedhojë kanë përmbushur në formë dhe substancë kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

16. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuessit është përmbyllur me vendimin nr. 00-2023-4181(341), datë 19.10.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur dhe regjistruar në datën 19.2.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuessit legjitimohen edhe *ratione temporis*.

17. Në drejtim të legjitimitit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuessit kanë pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës private, standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të drejtën për përfitimin e një shpërblimi të drejtë dhe parimin e mosdiskriminimit. Në lidhje me këtë të fundit, ata kanë parashtruar se vendimet e kundërshtuara i kanë vendosur ata në pozita diskriminuese, pasi arsyetimi i gjykatës së apelit vjen në kundërshtim të hapur me provat e paraqitura, me ligjin, me vendimin nr. 12/2000 të Gjykatës, si dhe me praktika të ngjashme gjyqësore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Edhe në jurisprudencën kushtetuese është konsoliduar qëndrimi i Gjykatës në lidhje me pozitën e kësaj kategorie pronarësh, për sa i përket legjitimitit të kërkimit të tyre për përfitimin e dëmshpërblimit të drejtë nga shteti.

18. Gjykata ka pohuar se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar rrethanave të çështjes konkrete. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete, nuk mund të justifikojë pretendimet për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është

specifike dhe ka individualitetin e saj, e harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimin nr. 19, datë 21.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuësve për cenimin e parimit të mosdiskriminimit nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuësve, vërehet se argumentet e parashtruara prej tyre, në thelb, kanë të bëjnë me të drejtën për një shpërblim të drejtë, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, në lidhje me detyrimin e organeve publike përkatëse për të paguar vlerën e plotë dhe reale të shtëpisë së fituar me kontratë shitblerjeje dhe më pas të kthyer ish-pronarit me vendimin e KKKP-së, Korçë-së. Neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca kushtetuese (*shih vendimin nr. 14, datë 7.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*), kanë pranuar se kërkesat për dëmshpërblim nënkuptojnë “një pasuri”, prandaj, në këto kushte, Gjykata vlerëson t’i shqyrtojë pretendimet e kërkuësve në drejtim të së drejtës së pronës private, e cila hyn në juridiksionin e saj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së pronës private

20. Kërkuësit kanë pretenduar se trashëgimlënësi i tyre e ka fituar pronësinë për banesën përmes kontratës së shitblerjes sipas legjislacionit të kohës dhe ka qenë pronar i saj që prej vitit 1958 deri në vitin 1994, kur kjo pronë i është kthyer ish-pronarit të saj në bazë të vendimit nr. 604/1994 të KKKP-së, Korçë. Ky vendim ishte i bazuar në nenin 10, paragrafi i parë, të ligjit nr. 7698/1993, sipas të cilit, personave të tretë shteti u kthente masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit, të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve. Edhe pse me vendimin nr. 12/2000 Gjykata ka shfuqizuar pjesërisht nenin 10 të lartpërmendur, në lidhje me masën e shpërblimit të personave të tretë blerës të pronës në shtet, ajo nuk e ka shuar të drejtën e tyre për të përfitur një shpërblim të tillë, pasi buron nga një vendim i KKKP-së, Korçë, i cili konsiderohet *quasi* gjyqësor, përbën titull ekzekutiv dhe është i detyrueshëm për t’u zbatuar. Akti normativ nr. 3/2012 ka të bëjë me një tjetër situatë juridike që nuk përputhet me atë të kërkuësve, pasi ata nuk kanë gëzuar statusin e të pastrehut, as të qiramarrësit në shtet, dhe as qiramarrësit të ish-pronarit. Në këtë kuptim, ky akt nuk plotëson as vakumin ligjor të krijuar nga shfuqizimi pjesërisht i nenit 10 të ligjit nr. 7698/1993, në përmbushje të detyrës së lënë nga Gjykata.

21. Subjekti i interesuar, Ministria e Financave, ka prapësuar se në kuptim të nenit 112 të KC-së, kërkitimi i kërkuësve është i parashikuar, pasi nuk është ushtruar brenda afatit 10-vjeçar të përcaktuar në ligj. Po kështu, kërkuësit nuk janë subjekte të shpronësuar, në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 9235/2004, ndaj nuk mund të legjitimohen në kërkitimin e tyre për dëmshpërblimin e një pasurie që nuk e kanë pasur në pronësi. Pasuria, për të cilën ata kërkojnë dëmshpërblim, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 7698/1993, u është kthyer ish-pronarëve me vendimin e KKKP-së, Korçë. Vetëm nota e transkriptimit nuk mund t’i legjitimojë ata për ngritjen e pretendimit në lidhje me dëmshpërblimin e një prone, të cilën ata nuk e kanë pasur të tyren. Me shfuqizimin e pjesshëm të nenit 10 të ligjit nr. 7698/1993, u krijua një vakum ligjor për përcaktimin e masës së shpërblimit, prandaj referenca bëhet në nenin 8, paragrafi 1, të ligjit nr. 9235/2004, sipas të cilit, e drejta e shpërblimit, në masën e çmimit të blerjes, konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, u njihet personave të tretë, vetëm në rastin kur mbi truall nuk ka ndërtesa të përhershme ose të ligjshme. Ligjvënësi ka nxjerrë aktin normativ nr. 3/2012, që ka plotësuar boshllëqet dhe paqartësitë që ekzistonin në ligjet nr. 7698/1993 dhe nr. 9235/2004. Sipas këtij akti, EKB-ja i dërgon BKT-së listën e personave të shpronësuar, me qëllim që këta të fundit të përfitojnë kredinë me 0%, me afat 30 vjet. Pra, akti normativ ka përjashtuar çdo mundësi tjetër për personat e shpronësuar për të kërkuar shpërblim me rrugë gjyqësore. Ky akt është marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata, e cila e ka gjykuar dhe është shprehur me vendimin nr. 1, datë 6.2.2013.

22. Gjykata ka theksuar se garantimi i së drejtës së pronës, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. E drejta e pronës, si e drejtë universale e njeriut, përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t’i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose

joproporcionale i kësaj të drejte. Në çdo rast, kjo e drejtë shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin. Megjithatë, me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'u nënshtrohet kufizimeve (*shih vendimet 53, datë 31.10.2023; nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 25, datë 28.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në këtë kuptim, Gjykata, bazuar dhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka pohuar se e drejta e pronës përfshin tre garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e saj: *garancia e parë* ka të bëjë me parimin e gëzimit të qetë të pronës, e cila ka natyrë të përgjithshme; *garancia e dytë* ka të bëjë me kufizimet e lejueshme për të drejtën e pronës; *garancia e tretë* ka të bëjë me të drejtën e autoriteteve publike për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Gjithsesi, sipas Gjykatës, kushti i baraspeshës midis interesave publike dhe private përmbysët kur persona të veçantë ose grupe sociale të veçanta mbajnë një peshë individuale tej masës ose shkallës së duhur, sado i rëndësishëm të jetë interesi i grupeve të tjera ose i komunitetit në përgjithësi (*shih vendimin nr. 53, datë 31.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjithashtu, sipas jurisprudencës kushtetuese, vendimet e organeve administrative që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave ndër vite nuk mund të konsiderohen akte administrative, në kuptimin normal juridik të termit (*strictu sensu*), por akte *sui generis* të nxjerra nga një organ *sui generis*, për të cilin GJEDNJ-ja ka përdorur termin *quasi gjykatë*. Në këto kushte, kur një person vinte në lëvizje KKKP-në, kërkesa ishte e barasvlershme si të ishte bërë përpara gjykatës dhe vendimi i KKKP-së ishte në gjendje të krijonte të njëjtën pritshmëri që krijon një vendim gjyqësor, i cili i njeh individit pronësinë për një send. Vendimet e ish-KKKP-ve, të cilat nuk janë ankimmuar brenda afateve ligjore, janë vlerësuar si vendime të formës së prerë, për rrjedhojë të ekzekutueshme dhe që nuk mund të vihen në diskutim as nga palët që kanë marrë pjesë në proces, as nga organet shtetërore të çfarëdo natyre qofshin (*shih vendimet nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 43, datë 6.10.2011; nr. 27, datë 26.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në këndvështrim të standardeve të sipërpërmendura, Gjykata thekson se me qëllim shqyrtimin e një çështjeje konkrete, ajo vlerëson vetëm ato fakte që janë të përcaktuara nga gjykatat e zakonshme dhe që përbëjnë fakte të natyrës kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Prandaj, bazuar në këto premisa, si dhe në thelbin e pretendimeve të kërkuessve, Gjykata do të analizojë në vijim nëse atyre u është cenuar e drejta e pronës nga sjellja e organeve publike, përfshirë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se me vendimin nr. 604/1994 të KKKP-së, Korçë, të pakundërshtuar, u është njohur masa e shpërblimit së shtëpisë sipas çmimit të shitjes në kohën e shitblerjes, të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve dhe në këtë kuptim nëse mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjes nga gjykatat ka rezultuar ose jo haptazi e paarsyeshme.

26. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, rezulton se vendimi nr. 604/1994 i KKKP-së, Korçë, ndërsa ka vendosur të njohë shtetasin B.V. si ish-pronar të shtëpisë së blerë në vitin 1958 nga trashëgimlënësi i kërkuessve, ka përcaktuar se shteti i detyrohej këtij të fundit pagimin e masës së shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e shitblerjes, të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, bazuar në nenin 10 të ligjit nr. 7698/1993.

27. Gjykata, me vendimin nr. 12/2000 ka shfuqizuar pjesërisht nenin 10 të ligjit nr. 7698/1993, pasi, sipas saj, rregulli për masën e shpërblimit për ndërtesat ish-pronë private që janë tjetërsuar nga persona të tretë, duke mos marrë për bazë çmimin e tregut, pra vlerën reale që ka ndërtesa në momentin e dorëzimit tek ish-pronari, vjen në kundërshtim me parimin e barazisë përpara ligjit. Gjithashtu, në këtë vendim, Gjykata përcaktoi se i takon organit ligjvënës, që në përputhje me përmbajtjen e këtij vendimi, të bëjë plotësimet përkatëse të dispozitës së shfuqizuar.

28. Vendimi KKKP-së, Korçë nuk është kundërshtuar nga palët. Banesa, objekt i këtij vendimi, i është kthyer ish-pronarit, ndërsa detyrimi i përcaktuar për shpërblimin e vlerës së pasurisë kërkuessve nuk është zbatuar nga organet publike. Për këtë arsye, kërkuessit dhe shtetasja R.T. kanë vënë në lëvizje gjykatat e zakonshme me kërkesëpadi me objekt detyrimin e subjekteve të interesuara për t'i paguar

vlerën e plotë dhe reale të banesës në shumën 4.802.150 lekë. Gjykata e shkallës së parë, bazuar në vendimin nr. 12/2000 të Gjykatës ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuësve, duke vendosur detyrimin e palës së paditur, Degës së Thesarit Korçë, që t'i paguajë secilit prej tyre shumën prej 1.600.716,67 lekësh (1/3-ën pjesë secilit). Ajo ka arsyetuar se pas shfuqizimit të nenit 10 të ligjit nr. 7698/1993 ekziston një boshllëk ligjor i papërmbushur nga ligjvënësi, por pavarësisht këtij fakti mungesa e ligjit nuk e shmang detyrimin e saj për të dhënë vendim, në kushtet kur në momentin e daljes së vendimit të KKKP-së, Korçë, neni 10 i ligjit të mësipërm ka qenë në fuqi (*shih faqet 5 dhe 6 të vendimit nr. 702, datë 21.9.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë*).

29. Gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka rrëzuar kërkesëpadinë e kërkuësve, si të pambështetur në ligj. Ajo ka arsyetuar se kërkuësit nuk mund të kompensohen në lidhje me masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit, të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, pasi neni 10 i ligjit nr. 7698/1993 është shfuqizuar pjesërisht nga vendimi nr. 12/2000 i Gjykatës. Sipas gjykatës së apelit, kërkuësve nuk u është cenuar e drejta e pronës, në kushtet kur ata kanë qenë posedues e banues në të dhe prona u është kthyer trashëgimtarëve të ish-pronarit të saj me vendimin e KKKP-së, Korçë. Kërkimi i kërkuësve për të përfituar shpërblim të plotë dhe real për pasurinë-banesë që ata kanë pasur në posedim dhe që i është kthyer pronarit të ligjshëm, është i pabazuar në ligj e në prova, pasi ata nuk janë shpronësuar nga pala e paditur, por prona i është kthyer pronarit të saj. Po sipas gjykatës së apelit, për rastin konkret, gjen zbatim akti normativ nr. 3/2012 dhe ligji nr. 82/2012, të cilët parashikojnë se kategoria e personave që janë banorë në banesa, që u janë kthyer ish-pronarëve, kanë të drejtën të aplikojnë dhe përfitojnë statusin e qytetarit të pastrehë, banues në banesat ish-pronë të subjekteve të shpronësuar dhe t'i drejtohen EKB-së për të përfituar kredi për banesë me kushte lehtësuese (*shih faqet 5 dhe 6 të vendimit nr. 2661, datë 10.12.2015, të Gjykatës Administrative e Apelit*).

30. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, duke arsyetuar se kërkuësit e kanë humbur banesën objekt gjykimi me vendim gjyqësor të formës së prerë, përmes të cilit është disponuar për lirimin dhe dorëzimin e saj tek trashëgimtari i ish-pronarit. Vendimi nr. 12/2000 i Gjykatës gjen zbatim, për rastin konkret, duke e bërë të pazbatueshëm disponimin në vendimin nr. 604/1994 të KKKP-së, Korçë, për kthimin e vlerës së banesës, sipas nenit 10 të ligjit nr. 7698/1993, për më tepër kur ky vendim nuk është zbatuar ndonjëherë dhe është mbështetur në një dispozitë që është shpallur antikushtetuese nga Gjykata. Në këtë kuptim, kërkuësit nuk kanë ndonjë të drejtë subjektive që gëzon mbrojtje gjyqësore në bazë të vendimit të KKKP-së, Korçë. Sipas Kolegjit Administrativ, kërkuësit duhet të plotësojnë dhe të ndjekin procedurën e parashikuar nga akti normativ nr. 3/2012, i miratuar me ligjin nr. 82/2012, i cili është gjetur në përputhje me Kushtetutën (*shih paragrafët 17, 18 dhe 19 të vendimit nr. 00-2023-4181(341), datë 19.10.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

31. Në analizë të këtyre vendimeve, Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë bërë asnjë përpjekje për të interpretuar normat ligjore në atë drejtim që të prodhojnë një rezultat të pajtueshëm me Kushtetutën, duke garantuar të drejtat kushtetuese të kërkuësve. Konkretisht, duke u bazuar në vendimin nr. 12/2000 të Gjykatës, që ka shfuqizuar nenin 10, paragrafi i parë, të ligjit nr. 7698/1993, gjykatat nuk kanë marrë parasysh arsyetimin e këtij vendimi, i cili në asnjë rast nuk mohon të drejtën e shpërblimit personave të tretë, përkundrazi, konsideron si të drejtë kushtetuese sigurimin nga shteti të një shpërblimi të drejtë e të plotë të personave të tretë, duke marrë për bazë çmimin e tregut, pra vlerën reale që ka ndërtesa në momentin e dorëzimit tek ish-pronari. Po kështu, pavarësisht se gjatë procesit nuk është kundërshtuar fakti se pasuria objekt gjykimi është blerë nga trashëgimlënësi i kërkuësve përmes kontratës së shitblerjes së datës 20.11.1958, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë me një arsyetim formal dhe pa marrë në konsideratë vendimin e KPPP-së, Korçë, i kanë konsideruar ata si subjekte të aktit normativ nr. 3/2012 dhe ligjit nr. 82/2012, që do të thotë si persona me statusin e qytetarit të pastrehë, banues në banesat ish-pronë të subjekteve të shpronësuar. Po në këtë kuptim, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, është bazuar në një arsyetim formalist dhe interpretim të ngushtë të së drejtës së pronës, që nuk është në përputhje me qëllimin e nenit 41 të Kushtetutës, duke e bërë mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes haptazi të paarsyeshme.

32. Në vështrim të sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë standardet e lartpërmendura kushtetuese në raport me faktet e çështjes në shqyrtim, Gjykata vlerëson se organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë zbatuar detyrimin e përcaktuar në vendimin e KKKP-së, Korçë, i cili nuk është ankimuar dhe, si i tillë, nuk mund të vihej në diskutim (si vendim i një organi *quasi* gjykatë). Prandaj, në kushtet kur në përfundim të procesit gjyqësor kërkuesit nuk e kanë realizuar të drejtën e tyre të njohur me vendim të formës së prerë të KKKP-së, Korçë, Gjykata çmon se atyre u është cenuar e drejta e pronës. Në këtë drejtim, Gjykata çmon se duhet të shfuqizohet vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë, duke e dërguar çështjen për shqyrtim pranë saj. Kjo e fundit, duke u bazuar në kompetencat e saj, si gjykatë ligji, është në pozicionin e duhur për të shqyrtuar pretendimet e kërkuesve dhe për t'u dhënë përgjigje atyre në respektim të standardeve kushtetuese, si dhe duke plotësuar mangësitë dhe riparuar shkeljet e gjykatës së apelit.

33. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, është i bazuar, ndaj dhe kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-4181(341), datë 19.10.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 8.10.2024.

Shpallur më 11.11.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtare: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Fiona Papajorgji, Marjana Semini